



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.492/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Delushe Halimi, e me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditëses H. K., nga P., përfaqësuar nga avokati B. K. nga P., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë-DAPK, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesorë publik, të mbajtur në prezencë të paditëses dhe të autorizuarit të saj, e në mungesë të të paditurit, më dt.09.11.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H. K., nga P.. **Anulohet** aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - DAPK në Prishtinë me nr. dosje *numër i dosjes...* i dt.24.03.2014, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesorë në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prezencë paditëses dhe të autorizuarit të saj e në mungesë të paditurit, të thirrur në mënyrë të rregullt, e cila mungesën e ka arsyetuar me parashtrësën e datës 07.11.2016.

I autorizuari i paditëses, avokat B. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesepadisë, duke shtuar se sa i përket përgjigjes në padi prej fillimit MPMS-ja e ka kundërshtuar kërkesën e paditëses për pension të aftësisë së kufizuar, duke u mbështetur në raportin mjekësor të Komisionit të formuar nga ministria. Edhe pse paditësja është shurdh-memece, e cila as nuk flet e as nuk dëgjon dhe rrjedhimisht nuk ka aftësi të kufizuar të punës i përmbush të gjitha kushtet e parapara me neni 3 të Ligjit për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar. Paditësja e ka marrë pensionin për persona me aftësi të kufizuar një kohë të gjatë mirëpo, pastaj komisioni mjekësor që ne mendojmë që ka qenë jo profesional dhe raportin e tyre ia kanë përshtatur planprogramëve të qeverisë, për zvoglimin e personave që kanë të drejtë në pension me aftësi të kufizuara. I autorizuari i paditëses i ka propozuar gjykatës që padia të aprovohet, vendimi kontestues të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E paditura me anë të parashtrësës të dorëzuar më datë 07.11.2016, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi duke shtuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe se vendimi kontestues është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të marr vendim duke lënë në fuqi vendimin kontestues, kurse kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesorë të dt.09.11.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë; aktvendimi nr.5023687 i datës 24.03.2014, vlerësimi i Komisionit Mjekësor i dt.

15.01.2014, shqyrtimi i ankesave i dt. 10.03.2014, vendimi i dt.16.01.2014, ankesa e dt.12.02.2014, vendimi i dt. 04.03.2009, rishqyrtimi dhe rivlerësimi i komisionit mjekësor i dt. 03.03.2009, vendimi i dt.31.12.2004, si dhe është bërë shiqimi në dokumentacionin mjekësorë të paditësit i cili gjendet si prove në shkresat e lëndës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë, pretendimet e palës paditëse në seancë, thënjet e të paditurës në përgjigje në padi, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar del se, ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtët dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e aktvendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se "Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësorë të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditësit H. K., të dt.12.02.2013, në mënyrë të gjithanshme, në seancën e dt.10.03.2014, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësorë, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt.15.01.2014, dhe në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit për persona me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme. Poashtu në arsyetimin e këtij vendimit thuhet se Komisioni ekspert mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, ka vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor, ku për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor, si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe e përhershme, siç përcaktohet me ligjin 2003/23, me ç'rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë".

Me vendimin e të paditurës të dt.31.12.2004, gjykata vëren se paditëses i është aprovuar kërkesa për të drejtën në pension të Personave me Aftësi të Kufizuar nga dt.01.01.2004, për

periudhën kohore prej 5 (pesë) vite, edhe me vendimin e datës 04.03.2009, i është vazhduar edhe për pesë (5) vite.

Ndërsa, me vendimin e të paditurës të dt. 16.01.2014, gjykata gjen se paditëses i është refuzuar kërkesa për pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuara, me konstatim se arsye e refuzimit të kërkesës është "bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtrueses të kërkesës dhe është ardhur në përfundim se te ju, aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston".

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në aktvendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është rikthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur me aktvendimin e dt.16.01.2014, ia ka refuzuar kërkesën për pension, kurse nga vlerësimi i Komisionit Mjekësor i dt.15.01.2014, nuk shihet se si ka ardhur deri në këtë përfundim, pasi që paditësja këtë të drejtë e ka shfrytëzuar për një periudhë kohore ku shihet edhe nga vendimi dt. 31.12.2004 deri më 16.01.2014, ku kjo e drejtë i është njohur për periudhën 10 (dhjetë) vjeçare, ku për këtë periudhë kohore e njëjta i ka plotësuar kushtet për të qenë përfituese e pensionit për Personat me Aftësi të Kufizuar të Plotë dhe të Përhershme.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.492/14 dt.09.11.2016.

Procesmbajtësja
Nazmije Beka

Gj y q t a r j a
Delushe Halimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.